



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

KALENDARI I SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR

Shkurt 2008

TABELA E LËNDËS

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM [SKZHI]	4
INTEGRIMI EVROPIAN	9
ANALIZA MAKROEKONOMIKE	17
PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM [PBA]	19
INVESTIMET PUBLIKE [PBA]	22
NDIHMJA E HUAJ	25

AKRONIMET E PËRDORURA NË TEKST

DBSKNH	Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj
DShIP	Dokumenti Shumëvjeçar Indikativ i Planifikimit
GSBI	Grupi i Punës për Strategji, Buxhet dhe Integrim
IPA	Instrumenti i Para-Aderimit
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
MF	Ministria e Financave
MIP	Menaxhimi i Investimeve Publike
MIE	Ministria e Integritit Europian
NjQFK	Njësia Qendrore e Financimit dhe Kontraktimit
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PIM	Plani i Integruar i Ministrisë
PMM	Plani i Monitorimit të Ministrisë
PShIP	Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit
RPP	Rishikimi i Politikës së Programit
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
SI	Sistem Informacioni

Kalendari i Sistemit të Planifikimit të Integruar për vitin 2008 menaxhohet nga koordinatorët e caktuar për këtë, Laura Shimili (lshimili@km.gov.al) në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndhmës së Huaj, Kesjana Halili (khalili@minfin.gov.al) në Ministrinë e Financave dhe Patris Kraja (patris.kraja@mie.gov.al) në Ministrinë e Integritit Europian. Në ministrinë e linjës koordinatorët për kalendarin e SPI-së janë Sekretarët e Përgjithshëm.

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM [SKZHI]

Proceset dhe produktet kryesore

1. Plani i Integruar i Ministrisë

- a. Raporti Vjetor mbi Rezultatet (2007)
- b. Plani i Integruar i Ministrisë (2008)
- c. Plani i Monitorimit të Ministrisë (2008)

2. Rishikimi i strategjive

- a. Rishikimi i strategjive, Dokumenti i Politikave Prioritare, PBA 2009-2011
- b. Rishikimi i strategjive, Dokumenti i Politikave Prioritare, PBA 2010-2012

3. Procesi i hartimit të PBA-së

- a. Vlerësimi i prioriteteve: Rishikimi i Politikës së Programit (RPP)
- b. Vlerësimi i prioriteteve: Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP)
- c. Vlerësimi i prioriteteve: Buxheti vjetor

4. Raporti Vjetor i Progresit për vitin 2007

Vështrim i përgjithshëm

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) që do të miratohet në fillim të vitit 2008, përmbledh 21 strategji sektoriale dhe 15 strategji ndërsektoriale. Gjatë vitit 2008 dhe viteve në vazhdim, vëmendja do të përqendrohet më shumë në zbatimin dhe monitorimin e SKZHI-së, nëpërmjet procesit kryesor të politikës dhe planifikimit financiar.

1. Plani i Integruar i Ministrisë

Plani i Integruar i Ministrisë (PIM) përmbledh angazhimet kryesore në kuadrin e PBA-së, përfshirë të gjitha angazhimet në kuadrin e integritimit evropian, legjislativonin e planifikuar, investimet publike madhore dhe projektet më të rëndësishme të ndihmës së huaj.

- a. Raporti Vjetor i Rezultateve (2007). Në fillim të vitit nga Ministrinë e Linjës, merren rezultatet e arritura mbi angazhimet e shprehura në Planin e Integruar të Ministrisë të vitit të mëparshëm dhe ato përmbledhen në Raportin Vjetor të Rezultateve, i cili bëhet publik.
- b. Plani i Integruar i Ministrisë 2008. Plani i Integruar i Ministrisë për vitin korrent hartohet pas miratimit në Parlament të buxhetit të shtetit dhe botohet në tremujorin e parë të vitit pasardhës.
- c. Plani i Monitorimit të Ministrisë 2008. Për monitorimin dhe raportimin gjatë vitit pasardhës, në dokumentin e PIM-it zgjidhen dhe publikohen një grup objektivash dhe detyrimesh ligjore të rëndësishme, që përbëjnë Planin e Monitorimit të Ministrisë. Këto objektiva dhe detyrime ligjore, përcaktohen në bashkëpunim me ministrinë e linjës në muajin shkurt. Monitorimi i tyre do të bëhet çdo tre muaj duke filluar në prill 2008 dhe do t'i raportohet edhe Komitetit të Planifikimit Strategjik (KPS).

2. Rishikimi i strategjive

Që në fillim të vitit 2008 do të fillojë procesi i planifikimit në kuadër të Procesit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2009-2011. DBSKNH luan këtu një rol shumë të rëndësishëm duke u siguruar që prioritetet e politikave të shprehura në strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, do të reflektohen gjatë procesit të PBA-së. Përpara fillimit të mirëfillt të procesit të PBA-së, Ministria e Financave dhe DBSKHN përgatisin tre materiale për Komitetin e Planifikimit Strategjik: 1) kuadrin makroekonomik (MF); 2) Dokumentin mbi Politikën Prioritare (DBSKNH); dhe 3) propozimet për tavanet buxhetore fillestare (MF).

a. Rishikimi i strategjive, Dokumenti i Politikave Prioritare, PBA 2009-2011

DBSKNH do të hartojë Dokumentin e Politikave Prioritare me qëllim që të ndihmojë Komitetin e Planifikimit Strategjik (KPS) në përcaktimin e taveve buxhetore të ministrive për përgatitjen e PBA-së 2009-2011. Ky dokument do të bazohet në propozimet e ardhura nga ministrinë dhe do të nëjtë gjithashtu edhe një analizë nga DBSKNH. Për të ndihmuar ministrinë e linjës do të shpërndahen udhëzime të përgatitura nga DBSKNH, në dhjetor 2007, bazuar mbi të cilat ministrinë do të identifikojnë politika të reja apo ekzistuese të pambuluara plotësisht me fonde në parashikimet e PBA-së 2008-2010, që kanë një vlerë të konsiderueshme financiare, që do të fillojnë të zbatohen në fillim të vitit 2009 dhe që mund të ndikojnë tavanet e tyre buxhetore për vitet 2009-2011. Propozimet e ministrive do të paraqiten për diskutim dhe aprovim në KPS në muajin shkurt. Aty do të vendoset për prioritetet që do të merren parasysh në përcaktimin e taveve, të cilët do të miratohen më pas në mbledhjen e KPS në fund të muajit shkurt.

b. Rishikimi i strategjive, Dokumenti i Politikave Prioritare, PBA 2010-2012

Ky proces do të ketë të njëjtën qasje si ai i përgatitjes së Dokumentit të Politikave Prioritare 2009-2011. Megjithatë ministrive të linjës do t'u lihet më shumë kohë për të përgatitur propozimet e tyre.

3. Procesi i hartimit të PBA-së

a. Vlerësimi i prioriteteve: Rishikimi i Politikës së Programit (RPP)

Në kuadrin e procesit të PBA-së, çdo ministri përgatit deklaratat për politikën e programeve të saj buxhetore të cilat shqyrtohen dhe rishikohen brenda ministrisë, gjatë muajit mars, pas caktimit të taveve për çdo ministri linje, për përgatitjen e PBA-së 2009-2011. Rishikimi i politikave të programeve përcakton shpenzimet e detajuara për secilin program si dhe projektet e investimeve, si dhe bën të mundur që ministrinë të hartojnë buxhetet indikative të programeve. DBSKNH në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Integritimit do të bashkërendojë procesin e RPP-së. Qëllimi i RPP-ve është që synimet dhe objektivat e shprehura në SKZHI, në strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, si dhe në MSA-së të reflektohen sa më mirë në kërkesat për shpenzime të ministrive të shprehura në PBA.

b. Vlerësimi i prioriteteve: Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP)

Gjatë periudhës maj – qershor, ministrinë e linjës paraqesin në ministrinë e financave, në kuadrin e PBA-së, Planifikimin e Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP). Këto parashikime rishikohen më pas, nga ministria e financave, DBSKNH dhe ministria e integritimit evropian, dhe prezantohen për diskutim në negociatat që zhvillohen me ministrinë e linjës. DBSKNH do të jetë pjesë e këtyre negociatave dhe do të fokusohet në realizimin e objektiveve të strategjive, nëpërmjet procesit të PSHIP. Mbi bazën e këtyre negociatave të zhvilluara ministria e financave përgatit një draft të PBA-së 2009-2011 të cilin e paraqet për diskutim dhe miratim në KPS. Gjithashtu DBSKNH do të përgatisë një vlerësim në lidhje me reflektimin e plotë/të pjesshëm të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale në PSHIP-të e çdo ministrie.

c. Vlerësimi i prioriteteve: buxheti vjetor

Parimisht nuk ka ndryshime të mëdha midis shpërndarjes së burimeve midis ministrive të linjës, të aprovuar në korrik dhe shpërndarjes përfundimtare të miratuar në buxhetin e shtetit në muajin tetor. Megjithatë nëse ka ndryshime të konsiderueshme DBSKNH do të bëjë një vlerësim për të matur impaktin e këtyre ndryshimeve në zbatimin e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale.

4. Raporti Vjetor për Progresin e SKZHI-së

Raporti Vjetor për Progresin e SKZHI-së paraqet ecurinë e arritur përkundrejt rreth 40 indikatorësh të nivelit të lartë. Një pjesë e mirë e këtij informacioni grumbullohet nëpërmjet INSTAT-it ose vëzhgimeve të veçanta dhe kërkon vetëm një kontribut modest nga ana e ministrive. Ky raport përgatitet në mes të vitit dhe aprovohet në muajin shtator.

KALENDARI PËR SKZHI-në PËR VITIN 2008

1. Plani i Integruar i Ministrisë (PIM)

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Shkurt	25	DBSKNH	Përgatit strukturën e PIM-eve 2008 si dhe udhëzimet për të raportuar mbi PIM-et 2007 dhe i dërgon te ministrinë e linjës
	3	DBSKNH Ministrinë	Negociohen indikatorët që do raportohen në Planet e Monitorimit të Ministrive 2008
Mars	17	Ministrinë	Ministrinë sjellin PIM-et 2008 të plotësuar dhe Raportin Vjetor të Rezultateve mbi PIM-et 2007
	24	DBSKNH	Finalizon PIM-et 2008 si dhe Planet e Monitorimit të Ministrive 2008
	31	DBSKNH	Publikohen PIM-et 2008 si dhe Raporti Vjetor i Rezultateve 2007
Prill		KPS	Raportohet mbi Planet e Monitorimit të Ministrive 2008
Korrik		KPS	Përgatitet raporti mbi Planet e Monitorimit të Ministrive 2008
Nëntor		KPS	Përgatitet raporti mbi Planet e Monitorimit të Ministrive 2008

2. Rishikimi i strategjive

Muaji	Data	Veprimi
Janar	14	Ministrinë dërgojnë zyrtarisht politikat e tyre prioritare për PBA 2009-2011
Shkurt	25	KPS miraton politikat prioritare më të rëndësishme bashkë me tavanet buxhetore për PBA 2009-2011
Prill		DBSKNH shpërmdan udhëzimet për dokumentin e politikave prioritare 2010-2012
Maj		DBSKNH paraqet një përmbledhje të lidhjeve midis strategjive dhe PSHIP në KPS
Tetor		DBSKNH identifikon çështje të strategjive në buxhetin vjetor

3. Procesi i hartimit të PBA-së

Muaji	Data	Veprimi
Janar	19	Aprovimi në KPS i kuadrit makro
Shkurt	25	Aprovimi në KPS i taveve buxhetore per PBA 2009-2011 bashkë me Politikat e Reja Prioritare të ministrive të linjës
Maj	2	DBSKNH përgatit dhe i dërgon komente MF për deklaratat e politikës së programit, në kuadër të analizës së PBA-së
	16	Përfundon analiza e PBA-së dhe e Kërkesave për Shpenzime të ministrive, për fazën e parë të PBA-së
	19-30	Zhvillohet cikli i dytë i seancave të diskutimeve të PBA-së ku ngren çështje mbi lidhjet midis strategjive dhe PSHIP
Qershor		DBSKNH paraqet një përmbledhje të lidhjeve midis strategjive dhe PSHIP në KPS
Shtator	15-26	Zhvillohet cikli i dytë i seancave të diskutimeve të PBA-së
Tetor		DBSKNH identifikon çështje të strategjive në buxhetin vjetor

4. Raporti Vjetor për Progresin e SKZHI-së

Muaji	Data	Veprimi
Shkurt		Shpërndahen udhëzimet për kontributin e ministrive në Raportin për Progresin për vitin 2006
Mars		Dërgohet kontributi nga institucionet e përzgjedhura
Qershor		Finalizohet raporti vjetori i progresit
Korrik		Botohet raporti

INTEGRIMI EVROPIAN

Proceset dhe produktet kryesore

1.Zbatimi i MSA-së:

- a.Vlerësimi i zbatimit të Planit Kombëtar për zbatimin e MSA
- b.Reflektimi i prioriteteve të Planit të zbatimit të MSA në procesin buxhetor dhe të PBA-se
- c.Monitorimi i Planit Kombëtar për zbatimin e MSA
- d.Analiza e Dokumentit të Partneritetit Evropian dhe Raportit Vjetor për progresin

2.Instrumenti i Para-aderimit (IPA)

- a.Rishikimi i Dokumentit Indikativ të Planifikimit Shumë-vjeçar
- b.Finalizimi i programimit IPA 2008
- c.Programimi i IPA-s 2009
- d.Decentralizimi

3.Fillimi i procesit të përkthimit të acquis në gjuhën shqipe

Vështrim i përgjithshëm

Qeveria shqiptare do të vazhdojë të mbetet e angazhuar plotësisht në zbatimin e axhendës së saj Evropiane, si një prioritet i politikës së jashtme, veçanërisht gjatë vitit 2008. Pas përbushjes së procesit të ratifikimit të MSA nga të gjithë vendet anëtare, gjatë vitit 2008 planifikohet që të realizohet dorëzimi i aplikimit për anëtarësim në Bashkimin Evropian, nga autoritetet shqiptare si dhe ndjekja e të gjithë procedurave të lidhura me të.

Datat e përcaktuara në kalendarët më poshtë në disa raste janë vetëm indikative. Ato do të saktësohen rast pas rasti, në varësi të kalendarit të shërbimeve të KE për çështjet përkatëse.

Në fillim të vitit 2008 parashikohet të ngrihet njëسيا e përkthimit të legjislacionit komunitar, proces i cili do të vazhdojë gjatë vitit. Prioritetet e përkthimit do të vendosen nga Ministria e Integrimit në bashkëpunim me ministrinë e interesuara.

1.Zbatimi i MSA-së

a.Vlerësimi i zbatimit të “Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së”

Ministria e Integrimit Evropian do të drejtojë procesin e rishikimit të Planit Kombëtar për zbatimin e MSA, bazuar në raportin e progresit të KE të Nëntorit 2007 dhe dokumentit të ri të partneritetit evropian. Këtë vit parashikohet gjithashtu edhe një rivlerësim i plotë i planit nga pikëpamja e formës dhe përmbajtjes, për të siguruar një lexueshmëri më të lartë dhe për të pasqyruar metodat e reja të raportimit elektronik.

b.Reflektimi i prioriteteve të Planit Kombëtar për zbatimin e MSA në PBA

Gjatë ciklit të planifikimit buxhetor, ministrinë e linjës duhet t'i kushtojnë një rëndësi të veçantë sigurimit të një lidhje organike midis prioriteteve të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA dhe procesit buxhetor afatmesëm. Per këtë arsye, kalendar i rishikimit të planit do të rakordohet me atë të përgatitjes së PBA.

c.Monitorimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së

Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA do të vazhdojë të monitorohet rregullisht çdo muaj gjatë vitit 2008 dhe Komisionit Evropian do t'i dorëzohen raporte tre-mujore. Disa të dhëna të raportimit mund të ndryshohen për t'iu përshtatur ritmit të kërkesave që vijnë nga Komisioni Evropian.

d.Analiza e Dokumentit të Partneritetit Evropian dhe Raporti Vjetor i Progresit

Në 6 Nëntor 2007, Komisioni Evropian prezantoi Dokumentin e ri të Partneritetit Evropian së bashku me Raportin Vjetor të Progresit gjatë procesit të Stabilizim-Asociimit. Qeveria do të vendosë për rishikimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së duke marrë parasysh përparësitë e reja të Dokumentit të Partneritetit. Një vendim në lidhje me këtë dhe kalendari përkatës nuk është përcaktuar ende.

2.Instrumenti i Para-aderimit (IPA)

Programi CARDS mbetet në fazën e zbatimit të projekteve dhe nuk kërkon më ndonjë veprimtari programuese. Planifikimi dhe programimi në lidhje me asistencën e BE tani bëhet vetëm për Instrumentin e Para-zgjerimit (IPA).

a.Dokumenti Indikativ i Planifikimit Shumë-vjeçar për periudhën 2007-2009

Gjatë vitit 2007 përfundoi marrëveshja e re kuadër për zbatimin e Instrumentit të Para-zgjerimit IPA, e cila parashikon rregullat e përgjithshme për shtetet përfituese për zbatimin e asistencës komunitare. Në bashkëpunim me Komisionin Evropian parashikohet të rishikohet dokumenti ekzistues i planifikimit shumë-vjeçar (MIPD) 2007-2009, në bazë të prioritetëve të Partneritetit të ri 2007.

b.Finalizimi i programit IPA 2008

Pas diskutimit dhe miratimit nga Komiteti IPA i Komisionit Evropian të programit IPA 2008 gjatë tremujorit të tretë 2008, do të nënshkruhet marrëveshja financiare për këtë program, e cila do t'i hapë rrugë implementimit të projekteve të përfshira në këtë program.

c.Programimi i IPA-s për vitin 2009

Procesi i planifikimit për IPA 2009 planifikohet të fillojë rreth muajit Shtator 2008. Sipas procedurave në fuqi lista e projekteve të identifikuara do të miratohet nga KPS dhe do t'i paraqitet Komisionit Evropian rreth muajit shkurt 2009.

d.Decentralizimi

Gjatë vitit 2007 hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë drejt decentralizimit të asistencës komunitare, përfshirë caktimin e zyrtarëve të programimit sektorial (SPO) në çdo ministri dhe ngritjen e njëjse qendrore të financimit dhe kontraktimit (CFCU) pranë Ministrisë së Financave. Parashikohet që akreditimi i strukturës së njëjse qendrore të financimit dhe kontraktimit (CFCU) bazuar në plotësimin e kërkesave të Komisionit Evropian mbi "Conferral of Management" të Shqipërisë të kryhet gjatë vitit 2009.

Kalendari i mëposhtëm është parashikim dhe Ministria e Financave do të jetë në kontakt me delegacionin evropian në kuadër të procesit kompleks të plotësimit të kërkesave për një menaxhim të decentralizuar të asistencës komunitare dhe akreditimin e CFCU, që do të jetë përgjegjëse për prokurimin, pagesat tek kontraktorët dhe disbursimin e fondeve, monitorimin e kontratave, auditimin, etj.

3.Përkthimi i *acquis communautaire* në gjuhën shqipe

Një komponent i rëndësishëm i periudhës së Stabilizim-Asocimit drejt anëtarësimit të plotë është përkthimi i legjislacionit evropian – *acquis communautaire* në gjuhën shqipe. Për këtë qëllim, në zbatim të VKM nr.119 për “Procedurat e përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe dhe legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit Evropian” në Janar 2008 do të ngrihet dhe funksionojë pranë Ministrisë së Integritimit Evropian, njësia e përkthimit të legjislacionit komunitar, e cila do të menaxhojë procesin e përkthimit të legjislacionit në bashkëpunim me të gjithë aktorët e përfshirë. Prioritetet e përkthimit do të caktohen në bashkëpunim me ministrinë përkatëse në vijim të konsultimeve të rregullta me Komisionin Evropian.

KALENDARI PËR INTEGRIMIN EUROPIAN PËR VITIN 2008

1A. Vlerësimi i zbatimit të “Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së”

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Mars	5-15	MIE Ministritë	MIE shpërndan udhëzimet dhe metodologjinë për rishikimin e PKZMSA-së. Ngrihen grupet ndërministrorë të punës që do të rishikojnë Planin Kombëtar. Vlerësimi i zbatimit të detyrimeve të parashikuara për periudhën korrik 2007-shkurt 2008 dhe analizimi i mosrealizimit të angazhimeve të ndërmarra.
	20	Ministritë	Rishikimi i afateve të realizimit të detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit
		Ministritë	Rishikimi i përgjegjësive institucionale të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga MSA
		Ministritë	Rishikimi i priorizimit të akteve legjislative të Bashkimit Evropian të cilat do të transpozohen në legjislacionin vendas
	30	Ministritë	Përshkrimi sektorial i ndihmës së huaj
Prill	10	MIE Ministritë	Rivlerësim i iniciativave ligjore që do të ndërmerren nga institucionet shtetërore në PKZMSA
	10	MIE Ministritë	Rivlerësim i aktiviteteve zbatuese që do të ndërmerren nga institucionet shtetërore në PKZMSA
	15	MIE Ministritë	Rivlerësim dhe ripërcaktim i kapaciteteve administrative të nevojshme, sipas fushave sektoriale
	30	MIE MF Ministritë	Rivlerësim dhe ripërcaktim i kostove financiare në përputhje me Planin Buxhetor Afatmesëm, 2009-2011
		MIE	Përditësim i sistemit të bazës së të dhënave me synim monitorimin elektronik të PKZMSA nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore
Maj Qershor		MIE Institucionet shtetërore	Korrespondenca në rrugë zyrtare ndërmjet MIE dhe institucioneve shtetërore për transferimin e të dhënave në sistemin data bazë të PKZMSA. Dërgimi i shkresave finale për të përmbyllur dokumentin final.
Korrik		MIE	Përpunimi i të dhënave dhe përgatitja e materialit final të PKZMSA 2008 – 2013 për dërgim në KM.
	4	MIE	Dërgimi i PKZMSA 2008- 2013 për miratim në KM
		KM	Miratimi i VKM Nr 577 për “Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 463 datë 5.07.2006 të KM, për miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së”
Shtator	20	MIE	Monitorimi i zbatimit të Planit nëpërmjet sistemit online

1B.Refektimi i prioriteteve të Planit Kombëtar për zbatimin e MSA në PBA

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Janar	14	DBSKNH Ministritë	Ministritë dërgojnë zyrtarisht politikat e tyre prioritare për PBA 2009-2011 që mund të reflektojnë iniciativat europiane
	19	KPS	KPS-ja miraton kuadrin makro
Shkurt	25	KPS	Aprovimi i tavaneve buxhetore për PBA 2009-2011 (bashkë me Politikën e Reja Prioritare të ministrive të linjës ndikon në zbatimin e integritimit evropian)
	25	MF	Shpërndahen udhëzimet për përgatitjen e buxhetit ku përfshihen edhe çështje që lidhen me integrimin evropian
Maj	2	Ministritë	Paraqiten në Ministrinë e Financave Deklaratat e Politikës së Programeve, PBA-ja dhe Kërkesat shtesë për Shpenzimet e ministrive, për fazën e parë të PBA-së përfshirë nisimat që lidhen me integrimin evropian
	2	KPS	Shqyrtohet dhe miratohet parashikimi i përditësuar makroekonomik.
	16	MF MIE DBSKNH	Përfundon analiza e PBA-së dhe e Kërkesave për Shpenzime të ministrive, për fazën e parë të PBA-së
	19	MF, MIE DBSKNH, Ministritë	Fillojnë përgatitjet për seancat e diskutimeve të PBA-së
	30	MF, MIE DBSKNH, Ministritë	Përfundojnë seancat e diskutimeve të PBA-së
Qershor	20	MF	Përfundon drafti i parë i PBA-së
Korrik	10	MF	Nxirret udhëzimi plotësues për përgatitjen e buxhetit
Gusht	29	KPS	Parashikimi i përditësuar makro dhe çështje të buxhetit shqyrtohen përpara paraqitjes së projekt buxhetit të shtetit për miratim përfundimtar nga Këshilli i Ministrave
Shtator	1	Ministrite	Paraqiten kërkesat e rishikuara të PBA-se në Ministrine e Financave për fazën e II të PBA-së
	12	Ministritë	Përfundohet përgatitja për ciklin e dytë të seancave të diskutimeve të PBA-së
	15	MF, MIE DBSKNH, Ministritë	Nis cikli i dytë i seancave të diskutimeve të PBA-së
	26	MF, MIE DBSKNH, Ministritë	Përfundon cikli i dytë i seancave të diskutimeve të PBA-së

1C. Monitorimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Janar	20	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Shkurt	20	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Mars	20	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
	25	MIE	Raporti tremujor për Komisionin Evropian
Prill	20	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Maj	20	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Qershor	20	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
	25	MIE	Raporti tremujor për Komisionin Evropian
Korrik	20	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
	25	MIE	Raporti i progresit për Shqipërinë për procesin e asociim-stabilizimit për periudhën shtator 2007 – qershor 2008
Gusht	20	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Shtator	20	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
	30		Raporti tremujor për Komisionin Evropian
Tetor	20	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Nëntor	20	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Dhjetor	20	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
	25	MIE	Raporti tremujor për Komisionin Evropian

2A. DSHIP dhe finalizimi i IPA-s 2008

Muaji	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Shkurt	MIE Komisioni Evropian	Rishikimi i DSHIP (MIPD) 2007-2009
	MIE	Dorëzohen në Komisionin Evropian projekt-fishat për projektet perfundimtare që do të përfshihen në IPA 2008
Shkurt-Prill	Komisioni Evropian	Këshillim brenda Shërbimeve të Komisionit
Korrik	Komisioni Evropian	Miratimi i fishave të IPA për vitin 2008 nga Komiteti i IPA
Nëntor-Dhjetor	Qeveria	Miratimi i Marrëveshjes Financiare të IPA-së për vitin 2008

2B. Programimi i IPA për vitin 2009

Muaji	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Qershor	MIE	Përgatitet Kalendari për Programimin e IPA-s
Korrik	MIE	Ngrihen grupet e brendshme të punës për identifikimin e prioriteteve sipas PKZMSA-së të rishikuar dhe hartohet lista e parë e projekteve
Korrik-Shtator	MIE DBSKNH Ministritë	Prioritet e indentifikuara nga Ministria e Integritimit diskutohen me përfituesit
Shtator	MIE DBSKNH Ministritë	Përfundojnë konsultimet me ministritë
Tetor	KPS	Miratimi në KPS i projekt ideve të IPA 2009
Tetor	Qeveria /Komisioni Evropian	Negociohen projektet e miratuara
Dhjetor	Ministritë	Finalizimi i projekt-fishave të IPA-s për vitin 2009

2D. Decentralizimi

Muaji	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Janar-Shkurt	MF CFCU	Sigurimi i Asistencës Teknike lidhur me CFCU
Qershor-Shtator	MF CFCU	Miratimi i struktures së re të CFCU
Shtator 2008 Shtator 2009	MF CFCU	Implementi i AT, draftimi i manualeve te procedurave, trajnimi i stafit

3. Përkthimi i Acquis Communautaire në gjuhën shqipe

Muaji	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Janar	MIE	Ngritja (buxheti dhe personeli) i Njesise se Perkthimit te acquis ne Ministrine e Integritimit
Shkurt-Mars	MIE	Hartimi i akteve nenligjore per funksionin e Njesise dhe procesit te perkthimit te acquis
Mars-Prill	MIE	Zhvillimi i procedurave per perzgjedhjen e perkthyesve dhe krijimi i Komitetit te Posacem ad-hoc te rishikimit te perkthimit
Prill	MIE	Konsultimet me ministrte e linjes per prioritizimin e akteve per t'u perkthyer
Maj-Dhjetor	MIE	Perkthimi acquis sipas prioriteteve

ANALIZA MAKROEKONOMIKE

Proceset dhe produktet kryesore

- 1.Vlerësimi dhe parashikimi makroekonomik
- 2.Aktualizimet ekonomike dhe financiare

Vështrim i përgjithshëm

1.Vlerësimi dhe parashikimi makroekonomik

Analiza dhe Parashikimi Makroekonomik për periudhën 2008-2011 përgatitet në fillim të vitit me qëllim që të ofrohet informacioni për përcaktimin e përparësive strategjike, shpenzimeve agregate synimeve në lidhje me të ardhurat dhe defiçitin, si dhe tavanëve për përgatitjen e PBA-së në nivel ministrie. Parashikimi fillestar përgatitet gjatë muajit dhjetor dhe finalizohet në mes të muajit janar. Vlerësimi dhe parashikimi përditësohen në dy momente kyç gjatë vitit: në muajin maj, përpara finalizimit të PBA-së dhe të Tavanëve të PBA-së për Shpenzimet (në këtë kohë mund të merren në shqyrtim edhe masat në lidhje me tatimin), dhe në muajin shtator, përpara se të dërgohet në Parlament projekt buxheti i shtetit.

Ndonëse nuk janë përfshirë në kalendar, misionet dy herë në vit të Fondit Monetar Ndërkombëtar mund të ndikojnë në politikën makroekonomike.

2.Përditësimet Ekonomike dhe Financiare dhe Raportet

Çdo tre muaj do të botohen përditësimet përsa i përket ecurisë ekonomike dhe financiare të vendit. Këto do të përgatiten brenda muajit pas fundit të çdo tremujori. Përveç kësaj, vlerësimi i fundvitit do të përfundohet përpara fundit të tremujorit të parë. Një raport vjetor i paraqitet Komisionit Evropian përpara fundit të muajit nëntor.

KALENDARI PËR ANALIZEN MAKROEKONOMIKE PËR VITIN 2008

1. Vlerësimi dhe Parashikimi Makroekonomik

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Janar	4	MF	Përfundojnë konsultimet e brendshme në lidhje me parashikimin makro
	7	MF	Dorëzohet parashikimi makro për t'u shpërndarë anëtarëve të KPS-së
	19	KPS	Miratohet parashikimi makroekonomik
Prill	25	MF	Dorëzohet parashikimi i përditësuar makro për të ofruar informacion për seancat e diskutimeve të PBA-se.
	28	MF	Dorëzohet parashikimi i përditësuar makro për t'u shpërndarë në KPS
Maj	2	KPS	Shqyrtohet dhe miratohet parashikimi i përditësuar makroekonomik
Gusht	22	MF	Dorëzohet parashikimi i përditësuar makro për të ofruar informacion për Ministrinë e Financës për të analizuar kërkesat e ministrive për buxhet
	25	MF	Dorëzohet parashikimi i përditësuar makro për t'u shpërndarë në KPS
	29	KPS	Parashikimi i përditësuar dhe çështje të buxhetit shqyrtohen përpara paraqitjes së projekt buxhetit të shtetit për miratim përfundimtar nga Këshilli i Ministrave
Nëntor-Djetor		MF	Nisin konsultimet e brendshme për kuadrin makro për periudhën 2009-2011

2. Përditësimet ekonomike dhe financiare dhe Raportet

Muaji	Data	Veprimi
Mars		Vlerësimi Makroekonomik dhe Financiar për vitin 2007
Prill		Përditësimi tremujor Ekonomik dhe Financiar për vitin 2008
Korrik		Përditësimi tremujor Ekonomik dhe Financiar për vitin 2008
Tetor		Përditësimi tremujor Ekonomik dhe Financiar për vitin 2008
Nëntor		Raporti Vjetor Makroekonomik për Komisionin Evropian

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM [PBA]

Proceset dhe produktet kryesore

Përgatitja e PBA-së për periudhën 2009-2011 dhe e buxhetit të shtetit 2009

Shënime:

- Datat dhe veprimet që lidhen me PBA-në përmenden edhe në pjesë të tjera
- Termi “ministri”, që përdoret në gjithë Kalendarin, në shumë raste do të vlejë edhe për agjencitë e pavarura.

Vështrim i përgjithshëm

Përgatitja e PBA-së për periudhën 2009-2011 dhe e buxhetit të shtetit 2009

PBA-ja e parë që përfshinte të gjitha ministrinë u zbatua në vitin 2006 (PBA-ja/buxheti për periudhën 2007-2009). PBA-ja u paraqit në Parlament bashkë me buxhetin e shtetit, për informacion. Në vitin 2008, fazat kyçe të PBA-së që do të zhvillohen nëpër ministri të ndryshme janë si më poshtë:

- Miratimi nga qeveria i vlerësimit dhe parashikimit makroekonomik
- Kaktimi i Taveve për Përgatitjen e PBA-së
- Përfundimi i Rishikimit të Politikës së Programit (RPP)
- Përfundimi i Planifikimit të Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP); dhe
- Paraqitja e PBA-së së ministrive dhe e Kërkesave për Shpenzime
- Shqyrtimi i kërkesave të Ministrive për PBA
- Zhvillimi i negociatave me Ministrinë e Linjës me pjesëmarrje edhe të MIE dhe DB SKNH
- Shqyrtimi në KPS i draftit të parë të PBA-së dhe miratimi i kuadrit makro të rishikuar (nr. 2)
- Shpërndarja e udhëzimit plotësues të buxhetit për përgatitjen e PBA-së së rishikuar (faza e dytë)
- Rishikimi i kërkesave për buxhet nga ministrinë e linjës dhe dërgimi i draftit të dytë të PBA-së në Ministrinë e Financave
- Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Ministrive
- Zhvillimi i negociatave me Ministrinë e Linjës me pjesëmarrje edhe të MIE dhe DB SKNH, për fazën e dytë.
- Shqyrtimi në KPS i dokumentit të rishikuar të PBA-së dhe miratimi i kuadrit makro të rishikuar (nr. 3)
- Dorëzimi në Këshillin e Ministrave dhe në Parlament i ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2009

Gjatë muajit korrik, qeveria do të shqyrtojë dhe miratojë draftin e parë të PBA-së dhe tavanet e PBA-së për shpenzimet. Gjatë muajit tetor do të shqyrtohet dhe miratohet drafti i dytë i PBA-së si dhe në nëntor buxheti i vitit 2009.

Në të kaluarën, vazhdimësia mes PBA-së dhe buxhetit ka rezultuar e dobët. Kjo situatë u përmirësua në vitin 2007, ndonëse kufijtë e ngushtë kohorë çuan në njëfarë mospërputhje. Qëllimi në vitin 2008 është që të realizohet një kalim pa probleme nga PBA-ja në buxhet. Në parim, të gjithë vendimet kryesore lidhur me shpenzimet duhet të kalojnë përmes procesit të miratimit të PBA-së dhe transformimi i PBA-së në Kërkesa të Ministrive për buxhet duhet të jetë kryesisht një detyrë teknike.

KALENDARI PËR PBA-NË DHE BUXHETIN PËR VITIN 2008

Përgatitja e PBA-së për periudhën 2009-2011

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Janar	4	MF	Përfundojnë konsultimet e brendshme në lidhje me parashikimin makro
	7	MF	Shpërndahen Tavanet për Përgatitjen e PBA-së per KPS-në
	7	MF	Dorëzohet parashikimi makro për t'iu shpërndarë anëtarëve të KPS-së
	19	KPS	Miratohet parashikimi makroekonomik dhe Kalendari i Sistemit të Planifikimit të Integruar 2008
Shkurt	18	KPS	Miratohen politikat prioritare që do të ndikojnë në përcaktimin e tavanëve
	25	KPS	Miratohen tavanet buxhetore për PBA 2009-2011 bashkë me Politikat e Reja Prioritare të ministrive të linjës
	25	MF	Shpërndahet udhëzimi për përgatitjen e buxhetit
Prill	25	Ministritë	GSBI miraton PshIP-në
	25	MF	Dorëzohet parashikimi i përditësuar makro për të ofruar informacion për seancat e PBA-së
	28	MF	Dorëzohet parashikimi i përditësuar makro për t'iu shpërndarë në KPS
Maj	2	KPS	Shqyrtohet dhe miratohet parashikimi i përditësuar makroekonomik.
	2	Ministritë MF MIE DBSKNH	Paraqiten në MF Deklaratat e Politikës së Programeve, PBA-ja dhe kërkesat shtesë për shpenzimet e ministrive, për fazën e parë të PBA-së dhe nis shqyrtimi i tyre
	16	MF MIE DBSKNH	Përfundon analiza e PBA-së dhe e Kërkesave për Shpenzime të ministrive, për fazën e parë të PBA-së
	19	Ministritë	Fillojnë përgatitjet për seancat e diskutimeve të PBA-së
	30	MF MIE DBSKNH Ministritë	Përfundojnë seancat e diskutimeve të PBA-së

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Qershor	20	MF	Përfundon drafti i parë i PBA-së
	25	KPS	Diskutohet drafti i parë i PBA-së në KPS
Korrik	10	MF	Nxirret udhëzimi plotësues për përgatitjen e buxhetit
Gusht	22	MF	Dorëzohet parashikimi i përditësuar makro për të ofruar informacion për Ministrinë e Financës për të analizuar kërkesat e ministrive për buxhet.
	25	MF	Dorëzohet parashikimi i përditësuar makro për t'u shpërndarë në KPS
	29	KPS	Parashikimi i përditësuar dhe çështje të buxhetit shqyrtohen përpara paraqitjes së projekt buxhetit të shtetit për miratim përfundimtar nga Këshilli i Ministrave
Shtator	1	Ministrinë	Paraqiten kërkesat e rishikuara të PBA-se në Ministrinë e Financave për fazën e II të PBA-së
	12	MF MIE DBSKNH	Përfundon analiza e PBA-së dhe e Kërkesave për Shpenzime të ministrive, për fazën e dytë të PBA-së
	12	Ministrinë	Përfundohet përgatitja për ciklin e dytë të seancave të diskutimeve të PBA-së
	15	MF MIE DBSKNH Ministrinë	Nis cikli i dytë i seancave të diskutimeve të PBA-së
	26	MF MIE DBSKNH Ministrinë	Përfundon cikli i dytë i seancave të diskutimeve të PBA-së
Tetor	10	KPS	Përgatitet materiali për t'u shqyrtuar nga KPS-ja, përfshirë makron e përditësuar
	24	MF	Paraqitet PBA për t'u shqyrtuar nga Këshilli i Ministrave
	31	Këshilli i Ministrave	Këshilli i Ministrave shqyrton buxhetin e shtetit dhe dokumentin e rishikuar të PBA-së
Nëntor	3	MF	Fillon hartimi i ligjit të buxhetit të shtetit; finalizohet dokumenti i PBA-së
	10	MF	Paraqitet në Parlament buxheti i shtetit bashkë me dokumentin përfundimtar të PBA-së
Dhjetor		Kuvendi	Parlamenti miraton buxhetin e shtetit

INVESTIMET PUBLIKE [PBA]

Proceset dhe produktet kryesore

- 1.Procedura të reja të Menaxhimit të Investimeve Publike
- 2.Integrimi i Menaxhimit të Investimeve Publike në PBA

Vështrim i përgjithshëm

Viti 2007 ishte një vit tranzicioni për arsye se procesi i ri i Menaxhimit të Investimeve Publike filloi të zbatohet në këtë vit. Sikurse në vitin 2007 edhe në vitin 2008 do të ofrohet trajnim për ministritë dhe do të hartohet një Sistem Informacioni (SI) mbështetës.

Planifikimi i investimeve publike do të vazhdojë në kuadër të procesit të PBA-së dhe të buxhetit. Për shembull, në tavanet për përgatitjen e PBA-së do të përfshihet një tavan për Investimet Publike për çdo institucion. Në kalendarin më poshtë janë paraqitur afatet kryesore përsa i përket PBA-së dhe buxhetit. Për të gjitha ato do të përfshihet një dimension i planifikimit të investimeve publike.

Në vitin 2008 do të përdoret një planifikim më i sofistikuar, i lidhur ngushtë me prioritetet dhe me strategjinë e qeverisë për asistencën e huaj.

KALENDARI PËR INVESTIMET PUBLIKE PËR VITIN 2008

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Shkurt	25	KPS	Miratohen tavanet buxhetore për PBA 2009-2011 bashkë me Politikën e Reja Prioritare të ministrive të linjës, përfshirë tavanet për investimet publike
	25	MF	Në udhëzimint për PBA-në do të përfshihen udhëzimet për investimet publike
Maj	2	Ministrinë	Ministrinë paraqesin në MF Deklaratën e Politikës së Programeve, për fazën e parë të PBA-së si dhe kërkesat shpese për shpenzime të ministrive, përfshirë investimet publike.
	16	MF	Përfundohet analiza e PSHIP-eve
	19	MF MIE DBSKNH Ministrinë	Fillojnë seancat e diskutimeve të PBA-së
	30	MF MIE DBSKNH Ministrinë	Përfundojnë seancat e diskutimeve të PBA-së
Qershor	20	MF	Përfundon drafti i parë i PBA-së, përfshirë investimet publike.
	25	KPS	Diskutohet drafti i parë i PBA-së në KPS
Korrik	10	MF	Nxirret udhëzimi plotësues për përgatitjen e buxhetit; përfshirë udhëzime për investimet publike.
Shtator	1	Ministrinë	Paraqiten kërkesat e rishikuara të PBA-së në MF, për fazën e dytë të PBA-së
	12	MF MIE DBSKNH	Përfundon analiza e PBA-së dhe e Kërkesave për Shpenzime të ministrive, për fazën e dytë të PBA-së
	12	MF	Përfundon përgatitja për ciklin e dytë të seancave të diskutimeve të PBA-së
	15	MF MIE DBSKNH Ministrinë	Nis cikli i dytë i seancave të diskutimeve të PBA-së
	26	MF MIE DBSKNH Ministrinë	Përfundon cikli i dytë i seancave të diskutimeve të PBA-së

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Tetor	10	MF	Përgatitet materiali për t'u shqyrtuar nga KPS-ja, përfshirë makron e përditësuar dhe dokumentin e rishikuar të PBA-se, përfshirë çështje që lidhen me investimet pubike.
	24	MF	Paraqitet materiali për t'u shqyrtuar nga Këshilli i Ministrave
	31	Këshilli i Ministrave	Këshilli i Ministrave shqyrton buxhetin e shtetit dhe dokumentin e rishikuar të PBA-së
Nëntor	3	MF	Fillon hartimi i ligjit të buxhetit të shtetit; finalizohet dokumenti i PBA-së
	10	MF	Dërgohet në Parlament buxheti i shtetit bashkë me dokumentin përfundimtar të PBA-së

NDIHMA E HUAJ

Proceset dhe produktet kryesore

- 1. Dokumenti për Orientimin e Ndhmës së Huaj**
- 2. Koordinimi i donatorëve**
- 3. Deklarata e Parisit, anketa OECD/DAC**
- 4. Hartimi i procedurave të reja të menaxhimit të ndihmës së huaj**

Vështrim i përgjithshëm

- 1. Dokumenti për Orientimin e Ndhmës së Huaj**

Dokumenti për Orientimin e Ndhmës së Huaj do të përfundojë dhe do të lançohet në fillim të vitit 2008. Ky dokument përmbledh përparësitë afatmesme të qeverisë për t'u siguruar që ndihma e huaj përforcon arritjen e qëllimeve të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale. Ai do të shërbejë si bazë për përgatitjen e PBA-së nga minsitritë e linjës.

- 2. Koordinimi i donatorëve**

Koordinimi I donatorëve do të bëhet në forma të ndryshme, përmes dy konferencash, tryezash të rrumbullakëta sektoriale, misionesh, negociatash dypalëshe, dhe programesh speciale. Gjithashtu do të vazhdojë bashkëpunimi me sekretariatit teknik të donatorëve dhe grupin mbështetës për SPI-në, i ngritur për të monitoruar zbatimin e fondit të përbashkët të SPI-së, prej 7 milion USD. Datat e dy konferencave që do të zhvillohen gjatë vitit janë përfshirë në kalendarin më poshtë.

- 3. Deklarata e Parisit, anketa e monitorimit OECD/DAC**

Çdo dy vjet palët nënshkruese të Deklaratës së Parisit grumbullojnë të dhënat e nevojshme për të raportuar lidhur me treguesit e saj dhe për tu përgatitur për konferencën. Këtë vit lançimi i anketës 2008 është bërë në muajin Janar dhe anketa do të zhvillohet për të arritur afatin e përfundimit brenda datës 31 mars 2008.

- 4. Hartimi i procedurave të reja të menaxhimit të ndihmës së huaj**

Në 2008 do të fillojnë të hartohen procedura të reja të menaxhimit të ndihmës së huaj. Ato do të jenë plotësuese të procedurave të menaxhimit të investimeve publike të miratuara dhe zbatuara në 2007. Kjo do t'i hapë rrugë edhe krijimit të sistemit të informacionit për ndihmën e huaj, që do të bashkërendohet me një sistem informacioni për menaxhimin e investimeve

KALENDARI PËR ASISTENCËN PËR NDIHMËN E HUAJ PËR VITIN 2008

1. Dokumenti për Orientimin e Ndhmës së Huaj

Muaji	Data	Veprimi
Janar		Ministritë aprovojnë dokumentin përfundimtar
Shkurt		Miratohet në KPS dokumenti përfundimtar

2. Koordinimi i donatorëve

Muaji	Data	Veprimi
Janar		Takim i grupit mbështetës të SPI-së
Prill		Takim i grupit mbështetës të SPI-së
Qershor		Konferencë me donatorët
Tetor		Takim i grupit mbështetës të SPI-së

3. Deklarata e Parisit, anketa OECD/DAC

Muaji	Data	Veprimi
Janar		Lancohet fillimi i anketës në një takim me donatorët
		Dërgohen pyetësorët te donatorët/ministritë e linjës
Shkurt		Mblidhen pyetësorët e plotësuar dhe analizohen të dhënat
Mars	28	DBSKNH transmeton rezultatet e anketës së monitorimit të OECD
Maj		Dërgohet draft raporti nga OECD
		Mblidhen komentet nga qeveria dhe donatorët
Shtator	2	Konferenca e nivelit të lartë në Akra për efektivitetin e ndihmës së huaj

Shënim: nuk do të ketë kalendar për aktivitetin e katërt, procedurat e reja të menaxhimit të ndihmës së huaj pasi nuk dihet ende se kur do të mbarojnë.

KOMITETI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK – GRAFIK PARAPRAK

Muaji	Data	Veprimi
Janar	19	Kuadri makroekonomik Kalendari i Sistemit të Planifikimit të Integruar
Shkurt	25	Tavanet e ministrive për PBA dhe Dokumenti mbi Politikat Prioritare Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI)
Prill		Raportohet mbi Planet e Monitorimit të Ministrive 2008
Maj	2	Shqyrtohet dhe miratohet parashikimi i përditësuar makroekonomik.
Qershor	26	Diskutohet drafti i parë i PBA-së në KPS
Korrik		Raportohet mbi Planet e Monitorimit të Ministrive 2008
Gusht	29	Parashikimi i përditësuar dhe çështje të buxhetit shqyrtohen përpara paraqitjes së projekt buxhetit të Shtetit për miratim përfundimtar nga Këshilli i Ministrave
Tetor	10	Shqyrtohet drafti përfundimtar i PBA-së, përfshirë makron e përditësuar
		Miratimi i projekt ideve të IPA 2009
Nëntor		Raportohet mbi Planet e Monitorimit të Ministrive 2008

*Datat e takimeve të Komitetit të Modernizimit të Qeverisë do të përcaktohen gjatë vitit, sipas nevojave për të miratuar metodologji apo dokumente teknike.
Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave zhvillon takime të rregullta me Sekretarët e Përgjithshëm të ministrive të linjës çdo muaj.*

